



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. _____/2023

PËR

**NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.96/2016, “PËR STATUSIN
E GJYQITARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN
E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

Neni 1

Shkronja “a”, e pikës 5, të nenit 12, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) paga referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë, e cila është e njëjtë me shumëzimin e koeficientit 0.36 me pagën e Presidentit të Republikës. Paga referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë indeksohet me vendim të Këshillit të Ministrave, jo më vonë se dy vite nga indeksimi i fundit. Niveli i indeksimit, në çdo rast, nuk kalon një pikë përqindjeje mbi nivelin e targetuar të inflacionit nga Banka e Shqipërisë.”.

Neni 2

Dispozitë tranzitore

Paga referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë indeksohet për herë të parë nga Këshilli i Ministrave, jo më herët se data 1.1.2026.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit të tij në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

LINDITA NIKOLLA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. _____, datë _____

P Ë R

**PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR NJË NDRYSHIM
NË LIGJIN NR.96/2016, “PËR STATUSIN E GJYQARËVE
DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 81, pika 1, dhe 100, të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Propozimin e projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, për shqyrtim e miratim në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, sipas tekstit dhe relacionit që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

MINISTRI I DREJTËSISË

ULSI MANJA